

No. 2070 Prot  
dt. 16.09.2022

Zyrës së Zyrtërisë



REPUBLIKA E SHQIPERISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

Nr.00148/830 Regj.Them

Sarandë me date 02.09.2022

Nr. 979/452 vendimi

**SHPALLJE VENDIMI**

**DREJTUAR: BASHKISE DELVINE**

**Per : Te paditurin Xhemal Buzheri , banues ne lagjen Lejla Malo Delvine**

Prane kesaj gjykate eshte gjykuar ceshtja civile me pale:

Padites: Aristulla Koçikori

I paditur: Xhemal Buzheri

Objekti: Zgjidhje martesë, Me vendimin nr. 979/452 date 08.06.2022 te Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Sarandë eshte vendosur:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.
2. Zgjidhjen e martesës mes paditësit Aristulla Koçikori dhe të paditurit Xhemal Buzheri.
3. Ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur Armalinda dhe Rafael Buzheri nga paditësja Aristulla Koçikori.
4. I padituri Xhemal Buzheri të drejtë të takojë fëmijët e mitur Armalinda dhe Rafael Buzheri, çdo fundjave, duke filluar nga ora 10:00 e ditës së shtunë deri në orën 10.00 të ditës së diele, të kalojë 15 ditë pushime verore me të, duke filluar nga data 1 deri në datën 15 të muajit Gusht, si dhe të kalojë me fëmijën 5 ditë gjatë pushimeve dimërore.
5. Detyrimin e të paditurit Xhemal Buzheri të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijët e mitur Armalinda dhe Rafael Buzheri në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për secilin, duke filluar ky detyrim nga momenti i ngritjes së padisë.
6. Një kopje e këtij vendimi, pasi merr formë të prerë, i dërgohet Zyrës së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Delvinë, për të bërë ndryshimet përkatëse.
7. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
9. Ky vendim është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbartimit pasi të marrë formë të prerë.

**U shpall në Sarandë, sot më datë 08.06 .2022.**

Duke qene se ne njoftimin per komunikimin e vendimit qe i eshte nisur nepermjet sherbimit postar te paditurit **Xhemal Buzheri , banues ne lagjen Lejla Malo Delvine**, rezulton "I larguar" bazuar ne nenin 133 te K.Pr.Civile nxirret kjo shpallje e cila ze vendin e komunikimit te vendimit. Nje kopje e kesaj shpalljeje dergohet per afishim ne **Bashkine Delvine** , dhe nje ne kendin e shpalljeve te Gjykeses Sarandë.

K/SEKRETARE